



**UNIVERSITETI I MITROVICËS**  
**UNIVERSITY OF MITROVICA**  
**"ISA BOLETINI"**

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës  
http://www.umib.net; Tel: +381-28535725/535727

Kryesues i Këshillit Drejtues  
Dr. sc. Sabri Sadiku

Nr. Prot. 16/005  
Datë 10.01.2017

Në bazë të vendimit të Këshillit Drejtues nr. prot. 1659, të datës 23.12.2016 Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini", shpall:

**KONKURS**

Për ndarjen e bursave universitare për studentët e studimeve themelore (bachelor) dhe studimet postdiplomike (master) të Universitetit të Mitrovicës, për vitin akademik 2016-2017.

I. Bursa universitare iu ndahet studentëve të studimeve bachelor dhe studimeve postdiplomike master.

Të drejtë aplikimi për bursë universitare kanë studentët, të cilët i plotësojnë këto kushte:

1. të jenë student të rregullt të Universitetit të Mitrovicës,
2. të jenë student të vitit të dytë e më lart,
3. të mos kenë vit të përsëritur të studimeve,
4. të kenë dhënë të gjitha provimet e vitit paraprak përkatës të studimeve në afatin e shtatorit,
5. të kenë notë mesatare të studimeve më së paku:
  - 8.0 (tetë pikë zero) – për studentët e studimeve bachelor në Fakultetin e Gjeoshkencave, Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore dhe Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike; dhe
  - 9.00 (nëntë pikë zero) – për studentët e Fakultetit Juridik, Ekonomik dhe të Edukimit.
  - 9.00 (nëntë pikë zero) – për studentët e nivelit master.

II. Studentët që i plotësojnë kushtet nga pika I e këtij vendimi duhet t'i paraqesin këto dokumente:

- Fletëparaqitjen (shkarkohet nga web-faqja e Universitetit)
- Vërtetimi për statusin e studentit (lëshohet nga Fakulteti)
- Pasqyra e notave (lëshohet nga Fakulteti)

III. *Shuma e mjeteve që do të ndahet për bursa universitare është 10 000 euro dhe do të ndahet në mënyrë proporcionale me numrin e fituesve të bursës.*

Studentët bursistë do ta gëzojnë këtë të drejtë për vitin akademik 2016-2017.

Afati i aplikimit zgjat prej datës 10.1.2017 deri më 25.1.2017.

Dorëzimi i dokumentacionit bëhet në fakultetet përkatëse.

Vendimi do të publikohet në tabelat e shpalljeve të fakulteteve dhe në web-faqen e Universitetit: [www.umib.net](http://www.umib.net).

Shkarkoni këtu Fletëparaqitjen për konkurrim për bursë universitare për vitin akademik 2016-2017.

